



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
DREJTORIA EKONOMIKE DHE ÇESHTJEVE SOCIALE

Nr 6119 Prot.

Ballsh, më 16.12.2025

PROJEKT VENDIM

Nr 53 Date 16 12 2025

**PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2026, DOKUMENTIT PËRFUNDIMTAR TË
PROJEKT BUXHETIT AFATMESEM 2026-2028 DHE NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË
PUNONJËSVE**

Në zbatim të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nën-pikat 1.1 shkronja "b", 1.3 shkronja "c", nenit 41 pika 1, neni 54 shkronja "c", të ligjit Nr 139/2015 "Per Vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr 9936 date 26-08-2008 "Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republiken e Shqiperise", të ndryshuar, kreu III nenet 10-20, kreu IV nenet 20-29, kreu VII nenet 39-41 të ligjit Nr 68/2017 datë 27.04.2017 "Per Financat e Vetqeverisjes Vendore", i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr 115/2024 "Per Buxhetin e Vitit 2025", nenin 9 të ligjit nr.35/2023 "Për kopentencat për caktimin e pagave , trajtimeve të tjera financiare ", të ndryshuar, udhëzimit nr.23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetqeverisjes vendore", udhëzimit nr.8 datë 28.02.2025 i Ministrisë të Financave "Për përgatitjen e buxhetit afatmesëm vendor 2026-2028 ", si dhe udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028" i datës 19.06.2024, vendimeve të Këshillit Bashkiak nr.12 datë 26.03.2025 "Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.25 datë 26.06.2025 "Për miratimin e dokumentit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2025-2027", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.35 datë 30.09.2025 "Për miratimin e dokumentit të rishikuar të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028", vendimit të Këshillit Bashkiak nr.40 datë 21.11.2025 "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore për vitin 2026", Kryetari i Bashkisë i propozon këshillit të Bashkisë Mallakastër:

1. Të miratojë Buxhetin e vitit 2026 ,dhe numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Mallakastër, si më poshtë:

1.1 Miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë Mallakastër dhe të institucioneve në varësi për vitin 2026 sipas **Tabelës Raporti BV5** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.2 Te miratoje planin e të ardhurave të vitit 2026, gjithsej në vlerën **1.019.531.088** (Një miliardë e nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tetë) **leke**, sipas kësaj strukture të ardhurash:

	<u>Në lekë</u>
- Të ardhurat nga Taksat dhe tarifat vendore	408.488.000
- Trasferta e Pakushtëzuar	282.465.170
- Trasferta Sektoriale	208.577.918
- Te ardhura të trashëguara	120.000.000
TOTALI I TE ARDHURAVE	1.019.531.088 lekë

1.3. Të miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2026 gjithsej në vlerën **1.019.531.088** (Një miliardë e nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e tridhjetë e një mijë e tetëdhjetë e tetë) **lekë**, sipas kësaj strukture shpenzimesh:

	<u>Në lekë</u>
- Pagat e punonjësve	428.083.008
- Sigurime Shoqërore dhe shëndetësore	70.184.564
- Shpenzime operative	173.631.943
- Shpenzime kapitale	322.685.373
- Trasferime te Organizata dhe individë	10.200.000
- Fondi për Emergjencat Civile	11.746.200
- Fondi i kontigjencës	3.000.000
TOTALI I SHPENZIMEVE	1.019.531.088 lekë

1.4 Te miratoj Planin e të ardhurave për vitin 2026 sipas përputhshmërisë me rregullat fiskale në fuqi për vetëqeverisjen vendore sipas **Tabelës Raporti BV3**, pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.5 Te miratoj tavanet e shpenzimeve për çdo program për vitin 2026 sipas **Tabelës Raporti BV2** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.6 Te miratoj detajimin e shpenzimeve për vitin 2026 në bazë të programeve dhe klasifikimeve buxhetore sipas **Tabelës Raporti BV6** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.


1.7 Te miratoj detajimin sipas zerave të investimeve sipas **Tabelës Raporti BV7** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

1.8 Te miratoj njësitë shpenzuese sipas **Tabelës Raporti BV9** pjesë përbërëse e këtij projekt-vendimi.

2. Të miratoj dokumentin përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm 206-2028 sipas tabelave bashkalidhur.

Dr. i Drejtorisë Ekonomike dhe Cështjeve Sociale

Aleksander Rama



KRYETAR
QERIM ISMAILAJ

